

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Dehja / es-Sukru / السُّكْرُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiale është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"قَالَ رَبِّ ارْنِي أَنْظُرُ إِلَيْكَ"

"... ai tha: 'Zoti im, shfaqu që të të shikoj.'"¹ (el-A'raf, 143)

Dehja² në këtë kontekst është një emër që i referohet humbjes së kontrollit gjatë gjendjes së ngazëllimit³. Kjo është nga shkallët e dashuruesve, duke qenë se bindjet e *fana*-s (vetasgjësimit) nuk e pranojnë këtë⁴ dhe shkallët e dijes nuk e mbërrijnë⁵. Ka tri shenja të dehjes:

¹ Imami (el-Harawi) mendon të thotë se, kur Musa dëgjoi Zotin, ai ra në një gjendje "dehjeje", e cila e bëri t'i kërkonte Atij t'i shfaqej.

² Imam Ibn el-Kajjim përmend në *Medaarixh* se ky emërtim nuk është më i miri. Sa herë që është përdorur në Shpallje ose nga komuniteti i parë (i besimtarëve), ka mbartur vetëm konotacion negativ. Pavarësisht kësaj, domethënia për të cilën flet Imam el-Harawi, është një domethënie fisnike dhe kjo gjendje është e njëmendtë, ndonëse jo aq e vlefshme sa gjendja e radhës (*Sehw/esëllima*).

³ Ngazëllimi që mund të vijë nga përjetimet intensive shpirtërore dhe nga përqendrimi në Hyjnoren deri në pikën e tretjes së vetvetes, mund të dobësojë kontrollin e personit duke rezultuar kjo në, për shembull, shprehje hermetike gjatë ekstazave të këtilla. Shih diskutimin rreth *shatahaat* të bërë në Hyrje (dokumenti i parë).

⁴ Meqë në gjendjen e *fana*-a (vetasgjësimit) nuk ka perceptim të vetvetes që të kihet ngazëllim.

⁵ Sepse dija e dashurisë nuk është e njëjtë sikurse gjendja e dashurisë. Ata që kanë dijen dhe janë të privuar nga gjendja, nuk do të përjetojnë këto stacione fisnike.

1. Mospëlqimi i preokupimit me transmetime (informata) me madhërim të përsosur⁶
2. Lundrimi përmes oqeanit të mallit me vendosje të përhershme⁷
3. Mbytja në detin e lumturisë me durim të trazuar⁸

Çfarëdo qoftë tjetër përveç kësaj, është thjesht një ngatërrim⁹, që me padije i referohet si dehje ose mistifikim dhe padrejtësisht quhet me këtë emër¹⁰.

Çfarëdo qoftë tjetër përveç kësaj, është e papërputhshme me qartësinë/mprehtësinë shpirtërore të vërtetë, siç është dehja e lakmisë¹¹, dehja e padijes, dhe dehja e epshit.

⁶ Imam Ibn el-Kajjim përmend në *Medarixh* se dëgjimi i transmetimeve nga i Dashuri dhe rreth të Dashurit është gëzimi i besimtarëve, por ata mund të kenë këtë mospëlqim, nëse kjo i parandalon t'i shërbejnë më fisnikërisht Atij ose nëse kjo vjen nga kanale shtinjake (d.m.th. mungesë sinqeriteti në transmetime).

⁷ Ndërsa lundrojnë përmes valëve të mallit, ata nuk harrojnë kërkesat e robërimit ndaj Zotit dhe i përmbahen dijes në të cilën vazhdojnë të qëndrojnë.

⁸ Malli i tyre shteron durimin e tyre dhe e dobëson atë.

⁹ Ngatërrimi dhe paqartësia janë të ndryshme nga dehja shpirtërore.

¹⁰ Mistifikimi është një shkallë më e ulët. Sipas shejhut (el-Harawi), dehja i përket seksionit më të lartë të realiteteve.

¹¹ Lakmia për kënaqësitë e dynjasë, përfshirë dhe lakminë egoiste për përmbushjen shpirtërore (të epërsisë), pa zbatuar mënyrat/mjetet e duhura për arritjen e kënaqësisë së Allahut.